

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6449
E martë, 26 tetor 2021
çmimi 0.40 €

Prof. Dr. Eqrem
ZENELAJ
dekorohet nga
Presidenti i
Republikës së
Shqipërisë SH.T.
Z. Ilir Meta me
titullin 'Kalorës
i Urdhërit të
Skënderbeut'



FAQE 10-11

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJYKATA SUPREME KA VENDOSUR PËR TRI ANKESA NDAJ VENDIMEVE TË PANELIT PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP) QË KANË TË BËJNË ME PARREGULLSITË NË PROCESIN ZGJEDHOR 17 TETORIT

HANI I ELEZIT NUK SHKON NË RIVOTIM, BALLAZHI FITUES I ZGJEDHJEVE



Gjykata Supreme e Kosovës e ka aprovuar të bazuar ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) lidhur me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Në këtë mënyrë, Supremja ka anuluar vendimin e PZAP-it që Hani i Elezit të shkojë në rivotim. Gjithashtu, kjo gjykatë ka refuzuar ankesën e Bekim Jasharit kundër vendimeve të PZAP-it

RRITEN ÇMIMET E PRODUKTEVE USHQIMORE NË KOSOVË, RËNDOHET BUXHETI FAMILJAR




PJESËTARËT E FSK-SË DEKOROHEN ME MEDALJE PAS KTHIMIT NGA MISIONI I PARË USHTARAK JASHTË VENDIT

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht--Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

EKONOMI



ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË NAFTËS PO VAZHDOJNË TË RRITEN NË BOTË

SPORT



ÇEKU: KOSOVA DO T'I NDJEKË RRUGËT LIGJORE NDAJ SERBISË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rama: Kosova ka përmbushur kriteret për liberalizim

TIRANË, 25 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në një editorial për "Politico.eu", thotë se BE-ja po humb fytyrën me mbrojtësit e saj më të fortë, ndërsa thekson se nëse Ballkani Perëndimor nuk mund të vijë në BE, ndoshta BE-ja mund të vijë në Ballkanin Perëndimor. Rama ka shtuar se Bashkimi

Evropian po turpërohet karshi Kosovës, duke mos ia dhënë liberalizimin e vizave. "BE-ja duhet të pranojë se po humb fytyrën me mbrojtësit e saj më të fortë, ndërsa përparimi ynë drejt anëtarësimit bllokohet nga vetëm një veto e çuditshme e kolateralit, Bullgaria. E njëjta pasiguri vlen edhe për Maqedoninë e Veriut, e

cila ka shkuar aq larg sa ka ndryshuar emrin dhe për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, të cilët tani janë më pak të lirë të udhëtojnë se më parë, edhe pse i kanë përmbushur të gjitha kërkesat e BE-së", ka deklaruar Rama, duke bërë të qartë se synimi i Shqipërisë është integrimi në BE.



Shefi i OBSH-së thotë se pandemia është larg përfundimit



GJENEVË, 25 TETOR - Shefi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) paralajmëroi se bota ka ende një rrugë të gjatë derisa të arrijë momenti kur mund të shpallet e përfunduar pandemia e Covid-19. "Kemi pothuajse 50 000 vdekje në javë bazuar vetëm në shifrat e raportuara. Pandemia është larg përfundimit", ka deklaruar shefi i OBSH-së, Tedros Adhanom Ghebreyesus, në Samitin Botëror të Shëndetit në Berlin më 24 tetor. Sipas tij, është në duart e njerëzimit për t'i dhënë fund pandemisë. "Ne kemi të gjitha mjetet e shëndetit publik që na

duhen, por bota nuk i ka përdorur mirë", ka thënë ai, duke shtuar se pandemia do të përfundojë atëherë kur bota do të zgjedhë t'i japë fund asaj. Kreu i OBSH-së sërish përsëriti thirrjen për shpërndarje më të drejtë të vaksinave kundër Covid-19. Ai ka theksuar se vendet që kanë arritur tashmë shkallën prej 40-përqindësh të vaksinimit, përfshirë të gjitha vendet e G20-s, duhet që t'ua lënë radhën e furnizimit vendeve të varfra. Ai shtoi se prodhuesit e vaksinave duhet të vendosin në përparësi dhe t'i përmbushin kontratat e tyre me Covax (program botëror

për shpërndarjen e vaksinave në vendet e varfra) dhe furnizimin në vendet e Afrikës. Ka kohë që OBSH-ja po u bënë thirrje prodhuesve të vaksinave që të heqin dorë nga pronësia intelektuale në mënyrë që më shumë vende ta fillojnë prodhimin e vaksinave. "Pengesha nuk është prodhimi, por politika dhe përfitimi", ka thënë Ghebreyesus. Pandemia u shpall në fillim të vitit 2020 dhe që nga ajo kohë, sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins", në shkallë globale janë infektuar mbi 240 milionë njerëz. Prej tyre, rreth 5 milionë kanë vdekur.

Berlini shpreh shqetësim për raportet diplomatike me Ankarën

"Jemi të shqetësuar dhe hutuar nga paralajmërimet e presidentit turk. Nuk ka pasur asnjë njoftim zyrtar nga pala turke

BERLIN, 25 TETOR - Gjermania tha se është e shqetësuar me paralajmërimet e presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, për dëbimin e ambasadorit gjerman në Ankara. "Jemi të shqetësuar dhe hutuar nga paralajmërimet e presidentit turk. Nuk ka pasur asnjë njoftim zyrtar nga pala turke. Ne jemi në konsultim të ngushtë me partnerët që janë prekur nga këto kërcënime", ka thënë zëdhënësi i qeverisë gjermane, Steffen Seibert. Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip

Erdogan, ka deklaruar të shtunën se ka urdhëruar Ministrinë e Jashtme të shpallë "persona non grata" (persona të padëshirueshëm) dhjetë ambasadorë nga shtetet perëndimore, përfshirë edhe atë të Shteteve të Bashkuara, pasi ata kanë bërë thirrje për lirimin e filantropistit Osman Kavala. Kavala është në burg që prej vitit 2017, pasi akuzohet se ka financuar protestat mbarëkombëtare të vitit 2013 dhe për përfshirje në tentim

grushtshtetin e vitit 2016. Ai i mohon të gjitha akuzat. Përmes një deklarate të përbashkët më 18 tetor, ambasadorët e Shteteve të Bashkuara, Kanadasë, Danimarkës, Francës, Gjermanisë, Holandës, Norvegjisë, Suedisë, Finlandës dhe Zelandës së Re kërkuar që sa më shpejt të zgjidhet çështja e Kavalas. Ata u thirrën në bisedë nga Ministria e Jashtme, që e quajti këtë deklaratë të përbashkët si të papërgjegjshme.



Izraeli planifikon ndërtime të reja në Bregun Perëndimor

JERUSALEM, 25 TETOR - Izraeli po planifikon të ndërtojë 1 355 shtëpi të reja banimi në Bregun Perëndimor të okupuar pavarësisht prej shqetësimeve të shprehura nga Shtetet e Bashkuara. Autoritetet izraelite publikuan më 24 tetor, tenderët për ndërtimin e shtëpive të reja në një sërë vendbanimesh në Bregun Perëndimor, në tokat e të cilit palestinezët synojnë ta kenë

shtetin e tyre të ardhshëm. Në luftën gjashtëditore të vitit 1967, Izraeli e pushtoi territorin e Bregut Perëndimor. Gjithashtu, pritet që në ditët e ardhshme një komitet qeveritar izraelit t'i diskutojë propozimet për ndërtimin e rreth 3 000 njësive të reja të vendbanimeve. Ministri i Strehimit në Izrael, Zeev Elkín, që i takon partisë së krahut të djathtë Shpresa e

Re, tha se "forcimi i pranisë hebreje në Bregun Perëndimor ishte thelbësor për vizionin e vendit të tij". Por, Shtetet e Bashkuara kanë shprehur shqetësim me vendimin e Izraelit. Më 23 tetor një zëdhënësi i Departamentit të Shtetit të SHBA-së tha se hapa të tillë mund t'i rritin tensionet dhe t'i dëmtojnë përpjekjet për të arritur një marrëveshje paqeje.



Kërkohet vullnet politik për reformën në shërbimin e jashtëm

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 TETOR - Përfaqësuesit e partive politike dhe ata të shoqërisë civile e kanë vlerësuar të domosdoshëm ndryshimin e ligjit për shërbimin e jashtëm. Në tryezën e diskutimit të grupit për studime juridike dhe politike, ata kanë deklaruar se duhet të ketë vullnet politik për reformën në shërbimin e jashtëm. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryetar i komisionit

parlamentar për punë të jashtme, Haki Abazi, ka thënë se fillimisht është e nevojshme të ndërrohet mendësia e trajtimit të shërbimit të jashtëm dhe pastaj të fillohet reformimi i tij. "Qëllimi ynë është që mos të ketë hapësirë të ndikimeve politike të qeverive, kur ato ndërrohen dhe ky numër të zvogëlohet në 30 për qind. Është i domosdoshëm të kemi njerëz që janë të lidhur drejtpërdrejt me qeverinë që vjen pushtet, por jo gjithësi të jetë 50-50, pasi në atë formë ngushtohet hapësira për diplomatët e

karrierës", ka thënë ai.

Para një reforme në shërbimin e jashtëm, deputetja e PDK-së, Ariana Musliu-Shoshi, ka thënë se duhet të ketë një reformë të brendshme në MPJD. Ajo ka kritikuar edhe ministren Gërvalla për mostransparencë derisa ka theksuar se Kosova është në pauzë sa i përket politikës së jashtme. "Reformimi i jashtëm duhet të ndodhë me reformim të brendshëm. S'ka mundësi të ndodhë reformimi i jashtëm kur t'i ke zyrtarë që janë kthyer. Këta zyrtarë që kanë ardhur bredhin

në zyrë dhe nuk kanë përshkrim të punës", ka thënë Musliu-Shoshi.

Ndërsa ish-ambasadori dhe drejtori i KIPRED-it, Lulzim Peci, ka thënë se planifikimi i duhur është primar për funksionim të mirëfilltë të shërbimit të jashtëm pasi, pavarësisht prej ndryshimeve ligjore, nëse nuk ka planifikim, i njëjti do të dështojë. "Ne mund ta bëjmë ligjin më të mirë, por nëse nuk kemi planifikim të mirëfilltë brenda punës së MPJD-së, nuk do të funksionojë. Planifikimi është

abc-ja, të jeni të bindur. Çka nënkuptoj unë me planifikim. Fillimisht ristrukturimin e ministrisë përbrenda. Drejtoria Politike të fillojë prej aty, pasi ambasadat janë satelitët e drejtorit", ka thënë Peci. Naser Shamolli nga GLPS-ja ka thënë se primare për shërbimin e jashtëm është meritokracia. Plotësim-ndryshimi i ligjit për shërbimin e jashtëm është në agjendën legislative të Qeverisë së Kosovës, mirëpo ende nuk është votuar në qeveri, rrjedhimisht edhe në Kuvend.



AGK, UN Kosovo Team dhe Kolegji AAB shënojnë Ditën e OKB-së

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Kolegjin AAB, të hënën me anë të një tryeze diskutimi shënuan Ditën e Kombeve të Bashkuara. Diskutimi mbi lajmet e rreme dhe verifikimin e fakteve gjatë pandemisë në Kosovë u zhvillua me studentët e Komunikimit Masiv të Kolegjit AAB. Paneli u udhëhoq nga kryetari i AGK-së, Xhemajl Rexha, ndërsa panelistë pjesëmarrës ishin gazetarët Jehona Zhitia, Bujar Vitija, Arbreshë Uka, Gentiana Hasani dhe Andelka Cup. Studentët e pranishëm më nga afër u njoftuan me vështirësitë

gjatë raportimit në kohë pandemie, si dhe sfidat e gazetarëve në luftimin e lajmeve të rreme dhe dezinformatave. Dita e OKB-së shënon përvjetorin e hyrjes në fuqi të Kartës së OKB-së në vitin 1945. Me ratifikimin e këtij dokumenti nga shumica e nënshkruesve të tij, përfshirë pesë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit, Kombet e Bashkuara u krijuan zyrtarisht. 24 tetori është festuar si Dita e Kombeve të Bashkuara që nga viti 1948. AGK në bashkëpunim me UNKT në vazhden e aktiviteteve për përmbytjen e SDG-ve, më 5 nëntor do t'i ndajnë çmimet mbi raportimet më të mira për çrënjoshjen e varfërisë.





GJYKATA SUPREME KA VENDOSUR PËR TRI ANKESA NDAJ VENDIMEVE TË PANELIT PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP) QË KANË TË BËJNË ME PARREGULLSITË NË PROCESIN ZGJEDHOR 17 TETORIT

Hani i Elezit nuk shkon në rivotim, Ballazhi fitues i zgjedhjeve

Gjykata Supreme e Kosovës e ka aprovuar të bazuar ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) lidhur me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Në këtë mënyrë, Supremja ka anuluar vendimin e PZAP-it që Hani i Elezit të shkojë në rivotim. Gjithashtu, kjo gjykatë ka refuzuar ankesën e Bekim Jasharit kundër vendimeve të PZAP-it

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 25 TETOR - Gjykata Supreme ka vendosur lidhur me tri ankesat e pranuar ndaj vendimeve të Panelit për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) që kanë të bëjnë me parregullsitë në procesin zgjedhor të 17 tetorit. Në ankesën e parë Kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës e ka aprovuar të bazuar ankesën e kandidatit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të komunës së Hanit të Elezit, Mehmet Ballazhi. Në këtë mënyrë është anuluar vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) për ta çuar në rivotim këtë komunë. "Aprovohet si e bazuar ankesa e Mehmet Ballazhit, kandidat për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), anulohet vendimi i Panelit

Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.693/2021, të datës 21.10.2021, dhe çështja i kthehet PZAP-it, në rivendosje", është thënë në njoftimin e Gjykatës Supreme. Në rastin e dytë, Supremja ka refuzuar ankesën e subjektit politik Lista e Pavarur Bekim Jashari kundër vendimeve të PZAP-it. "Kolegji i Gjykatës Supreme e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e subjektit politik Lista e Pavarur Bekim Jashari, me seli në Skenderaj, e paraqitur kundër vendimeve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa Anr.673/2021, Anr.674/2021, Anr.675/2021, Anr.676/2021, Anr.678/2021, Anr.679/2021 të gjithë të datës 20.10.2021, Anr.671/2021, Anr.672/2021, dhe 680/2021. Ankesa e subjektit të njëjtë, kundër vendimit të PZAP-së, A.nr.637/2021 hidhet si e palejuar", është thënë në njoftimin e gjykatës.

Kurse në ankesën e tretë, Kolegji i Gjykatës Supreme e ka refuzuar të pabazuar ankesën e Xh. S., anëtare e Komisionit Zgjedhor në vendvotimin QV2614/01D nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, e paraqitur kundër pikës III të vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A. nr. 630/2021, të datës 20.10.2021.

Do të rinumërohen tetë vendvotime për kryetarë dhe 35 për kuvende komunale

Kryeshefi i Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR), Burim Ahmetaj, ka thënë se duhet të rinumërohen tetë vendvotime për kryetarë dhe 35 për kuvende komunale pasi ka pasur mospërputhje të votave mes subjekteve dhe kandidatëve. Në mbledhjen e KQZ-së ai ka treguar edhe arsyet

pse këto vota duhet të rinumërohen. "Qendra e Numërimit dhe Rezultateve gjatë procesimit të formularëve, një numër i caktuar nuk kanë mundur të procesohen si të rregullta. Të dhënat që janë të shënuara në formularë nuk janë të kuptueshme. Meqenëse kemi të bëjmë me ngatërrim të rubrikave, pra kemi edhe mospërputhje të votave mes subjekteve e kandidatëve. Si rrjedhojë, gjatë hetimit konstatohet se nuk mund të procesohen si të tilla e rekomandohet që këto vendvotime të rinumërohen. Tetë vendvotime për kryetarë edhe 35 për kuvende komunale", ka thënë Ahmetaj. Të dielën në orët e vona në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve ka përfunduar numërimi i votave jashtë Kosovës, të cilat janë dërguar përmes postës në adresë të KQZ-së gjatë periudhës 15 shtator - 15 tetor për zgjedhjet lokale 2021. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka treguar të dielën se pas numërimit të votave me kusht, atyre të personave me nevoja të veçanta që do të bëhet të hënën, dhe pas konfirmimit nga PZAP-i

e Gjykata Supreme, do të bëhet shpallja e rezultateve përfundimtare. "KQZ-ja do t'i shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për kryetarë të komunave pasi të numërohen edhe votat me kusht dhe ato të personave me nevoja të veçanta që, sipas planifikimit tonë, do të numërohen të hënën, si dhe pasi t'i marrim konfirmimet nga PZAP-i dhe Gjykata Supreme", ka thënë Elezi në një konferencë për medie. Sipas rezultateve preliminare të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga 38 komunat ku janë zhvilluar zgjedhjet, në 16 komuna janë shënuar fitore të partive dhe 21 komuna do të shkojnë në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale në Kosovë i cili do të mbahet më 14 nëntor. Bazuar në rezultatet preliminare të KQZ-së, Lista Serbe ka fituar në nëntë komuna, Partia Demokratike e Kosovës në katër komuna, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës në dy komuna, kurse Lëvizja Vetëvendosje nuk ka arritur të fitojë asnjë komunë në raundin e parë.

Pjesëtarët e FSK-së dekorohen me medalje pas kthimit nga misioni i parë ushtarak jashtë vendit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 TETOR - Në Ministrinë e Mbrojtjes është mbajtur të hënën ceremonia e ndarjes së medaljeve për pjesëtarët e FSK-së të kthyer pas përfundimit të misionit të tyre në operacionin paqeruajtës dhe të stabilitetit përkrah forcave amerikane të Gardës Kombëtare të Iowas në Lindjen e Mesme në Kuvajt gjatë periudhës kohore maj-tetor 2021. Me këtë rast, zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Sylja, ndau medaljet “Pjesëmarrje në operacione ndërkombëtare” të akorduara nga ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, për major Mentor Ibrahim, kapiten

Kreshnik Haxhiu, toger Dhurim Shemsedini, tetar Hynor Lajqi dhe ushtar Mehmet Mehmeti. Kurse medaljet për “Shërbim të Shquar” ai ua dha pjesëtarëve nga Garda Kombëtare e Iowas, kapiten Wesley R. Gudenkauf dhe rreshter i klasës së parë Matthew G. Sandersen.

Sylja në emër të ministrit Mehaj ka theksuar se ka nderin e veçantë të përshëndesë ushtarakët që bënë historinë për Republikën e Kosovës me zbatimin e parë në mision paqeruajtës jashtë vendit përkrah aleatëve të përhershëm, forcave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. “Sot në këtë ceremoni jemi të gjithë të nderuar të përjetojmë këtë moment shumë të rëndësishëm që do të

mbetet kulminant që ka ndodhur ndonjëherë në historikun tonë ushtarak. Kjo është vetëm nisma dhe do të vazhdohet edhe më tutje me operacione të tjera kudo që na kërkohet dhe kudo që shtetet partnere kanë nevojë për ndihmën tonë”, ka deklaruar Sylja. Me këtë rast, ai ka falënderuar partnerët amerikanë për kontributin e tyre të dhënë për përfaqësimin e FSK-së jashtë vendit.

Gjithashtu, pjesëtarët e FSK-së u dekoruan edhe nga komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rrahman Rama, me medaljen për “Shërbim vetëmohues”, me “motivacion për kontributin e jashtëzakonshëm në operacionin e parë paqeruajtës”.

Në këtë ceremoni gjeneral Rama i ka përgëzuar pjesëtarët e dekoruar të FSK-së për misionin e kryer me sukses dhe për kontributin e dhënë në emër të paqes, stabilitetit dhe sigurisë globale. Gjithashtu, gjeneral Rama ka falënderuar ushtrinë amerikane për përkrahjen dhe bashkëpunimin e deritanishëm. “Falë partnerëve tanë strategjikë ne tani nuk jemi konsumues të sigurisë, por edhe e prodhojmë atë. Ky ka qenë misioni ynë - të kontribuojmë sa më shumë në paqen globale”, ka theksuar ai. Gjithashtu, gjeneral Rama u dha medaljen për “Shërbim vetëmohues” edhe pjesëtarëve nga Garda Kombëtare e Iowas me motivacion për kontribut të

jashtëzakonshëm në bashkëpunimin me kontingjentin e FSK-së në këtë operacion.

Në këtë ceremoni, ndër të tjera, atashu i mbrojtjes së ShBA-së, kolonel Stephen Rose, ka falënderuar ekipin e FSK-së për shërbimin e jashtëzakonshëm dhe profesional gjatë operacionit. “Ju keni kontribuar që ta bëni botën një vend të sigurt. Siguria vjen me paqe dhe me prosperitet”, ka theksuar kolonel Rose.

Kontingjenti i FSK-së ka realizuar shërbimin në kuadër të misionit paqeruajtës dhe stabilitetit në kuadër të Gardës Kombëtare të Iowas në Lindje të Mesme gjatë periudhës kohore maj-tetor 2021.

Kosova kërkon mbështetjen e Francës për anëtarësim në Interpol

Prishtinë, 25 tetor (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti dhe shefi i njësisë për trajtimin e materieve eksplozive, Muhamet Rushiti, qëndruan në vizitë disaditore në Paris të Francës. Qëllimi i vizitës ishte realizimi i takimeve të ndërsjella dhe pjesëmarrja në panairin prestigjioz të Milipol për shqyrtimin e zhvillimeve teknologjike nga fusha e sigurisë të cilat do të ndihmojnë avancimin e kapaciteteve institucionale relevante të Kosovës.

Gjatë kësaj vizite delegacioni në fjalë realizoi disa takime të rëndësishme me personalitete të

larta nga Franca, ndër ta drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, realizoi një takim të veçantë me drejtorin e Policisë Nacionale të Francës, Jerome Leonnet dhe përfaqësues të tjerë.

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka potencuar se policia e vendit tonë mbetet të jetë partnere e dëshmuar dhe e besueshme e Francës dhe se bashkëpunimi midis policisë së RKS-së me institucionet përkatëse të Francës është i shkëlqyeshëm.

Në kontekst të takimit u theksua se Kosova synon të jetë faktor stabiliteti në rajon dhe më gjerë dhe se, përkundër sukseseve të arritura në luftimin e krimit,

përmes ngritjes së bashkëpunimit, rezultatet e kësaj lufte do të jenë më të mëdha.

Pikë diskutimi në takim ishte përkrahja e Francës në procese të ndryshme përfshirë anëtarësimin e Kosovës në Interpol, Europol etj., për ta forcuar kështu luftën e përbashkët kundër krimit të organizuar dhe rritjen e sigurisë në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Nga ana tjetër u rikonfirmua vullneti i Francës për të vazhduar dhe forcuar bashkëpunimin në mes të dy institucioneve në fushën e sigurisë dhe forcimin e bashkëpunimit të mëtejshëm përmes luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe ngritjes së kapaciteteve shtetërore.



Ndryshimet kushtetuese, rrugë e vetme për vetingun



PRISHTINË, 25 TETOR - Vetingu në drejtësi në Kosovë nuk ka alternativë, por pa ndryshime kushtetuese nuk mund të ketë proces të vetingut, vlerësojnë Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe Arton Demhasaj nga Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet “Çohu”.

Më 13 tetor Qeveria e Kosovës e ka miratuar koncept-dokumentin për vetingun në drejtësi përmes të cilit synohet të forcohet sundimi i ligjit.

Vetingu është proces i rivlerësimit të figurës së prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe ka për qëllim rritjen e tyre profesionale, luftimin e korrupsionit dhe ndikimin e krimin të organizuar, politikës apo elementëve të tjerë të paligjshëm në dhënien e drejtësisë.

Grupi punues i themeluar nga Ministria e Drejtësisë, në konceptdokumentin e hartuar, ka sugjeruar “vetingun me ndryshime kushtetuese nga një trup ad-hoc dhe i njëjti më pas vazhdon vlerësimin e vazhdueshëm në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës”. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka theksuar se “edhe pasqyra aktuale ligjore lejon hapësirë për mbarëvajtje të procesit të vetingut përmes plotësimit-ndryshimeve të ligjeve relevante”.

Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, në një bisedë me “Radion Evropa e Lirë”, ka theksuar se ky institut, në bazë të analizave që ka bërë, ka nxjerrë përfundimin që proces

të vetingut, pa ndryshime kushtetuese, nuk mund të ketë. Sipas tij, çdo rrugë tjetër, përmes ndryshimeve ligjore, nuk mund të quhet veting. “Çdo proces që ka të bëjë me rritjen e integritetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, që bëhet pa amendamente kushtetuese, atëherë nuk mund ta ketë emrin veting. Ne mund ta quajmë si të duam, por atëherë nuk hyn në kuadër të atij vetingut gjithëpërfshirës në bazë, i cili ka për qëllim ta sigurojë pavarësinë dhe integritetin e këtij procesi, sepse me ligjet aktuale, me Kushtetutën aktuale, në qoftë se do të kishim një Këshill Gjyqësor dhe Këshill Prokurorial të pavarur, që zbatojnë ligjin dhe procedurën, nuk do të kishim nevojë fare të bëjmë veting”, ka thënë Miftaraj.

Pse duhen amendamentet kushtetuese për veting?

Mendim të njëjtë ka edhe Arton Demhasaj nga Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet “Çohu”. Ai, si përfaqësues i shoqërisë civile, ishte pjesë e grupit punues që ka hartuar konceptdokumentin për vetingun dhe që tashmë është pjesë e grupit punues për përgatitjen e bazës ligjore dhe ndryshimeve kushtetuese për vetingun të cilat do t'i propozohen Kuvendit të Kosovës nga Qeveria. Demhasaj shpjegon arsyet se pse ndryshimet kushtetuese janë të domosdoshme për ta realizuar procesin e vetingut. “Ne i kemi dy

nene në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të cilat i përcaktojnë kriteret se kur ne mund ta shkarkojmë ose ta largojmë nga detyra një prokuror apo një gjyqtar. Në ato nuk bëhet fjalë që lidhen me vetingun. Nëse ne arrijmë të bëjmë vetingun dhe del që një numër i caktuar i prokurorëve dhe gjyqtarëve nuk i plotësojnë kriteret për të vazhduar që të jenë pjesë e sistemit, nuk mund t’ua marrim mandatet sepse i mbron Kushtetuta. Prandaj janë të nevojshme ndryshimet kushtetuese, qoftë suspendimi i këtyre neneve për një kohë të caktuar, në mënyrë që ta funksionalizojmë dhe zbatojmë një proces të vetingut”, ka thënë Demhasaj.

Ai shton se për t’i bërë ndryshimet kushtetuese nevojiten dy të tretat e votave të Kuvendit që ka 120 deputetë, si dhe dy të tretat e 20 deputetëve të komuniteteve joshumicë. Demhasaj thotë se duhet të arrihet vullneti politik i të gjitha forcave politike shqiptare dhe atyre të komuniteteve joshumicë të cilat duhet ta kenë parasysh që vetingu është në të mirën e sistemit të drejtësisë dhe në interes të qytetarëve në përgjithësi. Por, Myftaraj shpreh mendimin që deri më tani, lidhur me procesin e vetingut, nuk ka pasur komunikim të duhur dhe debat të sinqertë nga ana e Qeverisë së Kosovës me subjektet opozitare, me shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

Por, sipas tij, një konsensus politik i të gjitha subjekteve parlamentare për ndryshimet kushtetuese lidhur me vetingun

është i domosdoshëm, marrë parasysh që, përveç partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, edhe partitë e mëdha opozitare, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në programet e tyre zgjedhore, në zgjedhjet e fundit parlamentare të 14 shkurtit, kanë paraparë realizimin e një procesi të vetingut. Për mbikëqyrjen e zbatimit të drejtë të vetingut në sistemin e drejtësisë, Myftaraj thotë se janë të domosdoshme mekanizmat që do ta mbikëqyrin këtë proces. “Koncept-dokumentin e ka përcaktuar në mënyrë të qartë që përmes ndryshimeve kushtetuese, kompetencat që i kanë aktualisht Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial do t’i delegoheshin, për një periudhë të caktuar kohore, një trupi të veçantë, i cila do të duhej të përbëhej nga ndërkombëtarët, ku përfshihen amerikanë, gjermanë dhe britanikë. Këta persona me ekspertizë, me përvojë dhe me integritet, do të bënin vlerësimin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve aktualë. Po flasim për një trup të jashtëm, i cili do të garantonte këtë proces, ku këshillat aktualë gjyqësorë dhe prokurorialë nuk do të kishin fare hise në këtë drejtim”, ka theksuar Miftaraj.

Të huajt s’mund ta bëjnë vetingun

Por, ndryshe mendon Demhasaj. Ai nuk beson që në mekanizmin mbikëqyrës të zbatimit të procesit të vetingut mund të jenë persona ndërkombëtarë. “Sepse nuk e

lejon Kushtetuta dhe baza jonë ligjore që dikush tjetër të vijë dhe të merret me veting. Ata mund të na ndihmojnë, të na sjellin ekspertë, të na ndihmojnë për atë sesi të krijohet mekanizmi. Por, që ta bëjnë ata vetingun dhe të jenë pjesë funksionale e mekanizmit, këtë nuk besoj që e lejon baza jonë kushtetuese”, ka pohuar Demhasaj.

Ai shton se afati kohor se kur do të përgatiten propozimet për ndryshime kushtetuese dhe kur mund të arrijnë ato si propozim i qeverisë në Kuvend, nuk është e përcaktuar. Për më shumë, sipas tij, as afati kohor i zbatimit të procesit të vetingut, në qoftë se eventualisht arrihen ndryshimet kushtetuese, nuk është i përcaktuar në mënyrë të prerë për shkak se, sipas tij, ky do të jetë proces i cili do të kalojë nëpër disa faza. Por, ai beson që procesi i vetingut do të realizohet brenda mandatit të qeverisë aktuale.

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian së fundmi ka kritikuar planin e Qeverisë së Kosovës që të bëjë veting “të njëhershëm të të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve”, duke vlerësuar se një gjë e tillë është “burim serioz i shqetësimit”.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka shprehur mospajtimin me këtë konstatim të Komisionit Evropian, duke thënë se procesi i vetingut “do të jetë i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës” dhe se “mosrealizimi i vetingut nuk u kontribuon as përpjekjeve të institucioneve të Kosovës për garantimin e sundimit të ligjit dhe as së ardhmes evropiane” të vendit.

Policia arreston një të dyshuar për veprën penale 'Dhënie e ryshfetit'

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar të hënën se në orën 08:40, në pikëkalimin kufitar Dheu i Bardhë, në hyrje nga Republika e Serbisë për në Republikën e Kosovës, ka ardhur një automjet me targa të Republikës së Serbisë në të cilin ishin dy persona, shtetas të Serbisë. Gjatë kontrollimit dhe regjistrimit të dokumenteve të personave dhe automjetit, i dyshuari ka paraqitur

dokumentet e nevojshme, por nuk ka paraqitur dëshmi për bashkudhëtarin e tij për kushtet e hyrjes në Republikën e Kosovës, i cili nuk kishte vaksinim të plotë kundër Covid-19. Nga zyrtarët policorë bashkudhëtarit i është refuzuar hyrja në RKS, bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat mbrojtëse kundër Covid-19. "Me këtë rast i dyshuari G.S. (1964) i ka ofruar ryshfet (10 euro) zyrtarit

policor në kabinën e kontrollit, me qëllim të lejimit të hyrjes në RKS edhe për bashkudhëtarin i cili nuk plotësonte kushtet e hyrjes në RKS. Personi i dyshuar është arrestuar nga zyrtarët policorë dhe për rastin është njoftuar prokurori i shtetit i cili ka urdhëruar iniciimin e rastit 'Dhënie e ryshfetit'. Personi i dyshuar është intervistuar dhe i njëjti me vendim të prokurorit është ndaluar për 48 orë", ka njoftuar Policia e Kosovës.



Për nëntë muaj, afër 1 400 raste të dhunës në familje në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 TETOR - Gjatë nëntë muajve të vitit 2021 në Kosovë janë regjistruar 1 548 raste të dhunës, prej të cilave 1 396 janë regjistruar si dhunë në familje. Në 445 raste ka pasur kërkesa për urdhër- mbrojtje të viktimave të dhunës në familje, kurse në 36 raste janë lëshuar urdhër- mbrojtje emergjente. Kështu njoftoi të hënën kryeprokurori i shtetit, Aleksandër Lumezi, në konferencën e parë me titull "Java për të drejtat e viktimave të

krimit".

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë me këtë rast se dhuna ndaj grave është bërë sfidë jo vetëm për institucionet, por edhe për shoqërinë e Kosovës në përgjithësi. "Ne nuk mund të heshtim ndaj kësaj gjendje, sikur nuk mund të heshtim as ndaj nevojës për mbështetje më të madhe të viktimave. Shkaktarët e krimit duhet të ndëshkohen, kurse viktimat duhet të rehabilitohen të inkurajohen dhe të mbështeten institucionalisht", ka thënë Osmani. Ajo ka shtuar se ndryshimet pozitive arrihen duke

punuar për zbatimin e ligjit dhe se, sipas saj, mosndëshkueshmëria e krimit kërkon zero tolerancë.

Kurse kryeprokurori Lumezi ka thënë se përpjekjet e sistemit prokurorial janë të vazhdueshme për parandalimin e krimit. Megjithatë, ai shtoi se janë të vetëdijshëm se ende duhet punë dhe përkushtim nga institucionet e drejtësisë për t'i parandaluar dhunimet, keqtrajtimet dhe vrasjet. "Këto çështje duhet të trajtohen me prioritet gjatë punës së përditshme të prokurorëve, policëve hetues dhe punonjësve

të tjerë të sistemit të drejtësisë. Prandaj, përkushtimi ynë duhet të jetë në bashkëpunim sa më të ngushtë ndërmjet institucioneve ligjzbatuese që në asnjë moment të mos ketë neglizhim në ndjekjen dhe ndëshkimin e atyre personave që cenojnë të drejtat, liritë themelore dhe vlerat e tjera të garantuara me Kushtetutë dhe konventat ndërkombëtare", ka thënë Lumezi.

Ministrja Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka ftuar bartësit e sistemit të drejtësisë që të marrin përgjegjësitë që, siç ka thënë ajo, t'u dilet ballë këtyre rasteve.

Haxhiu ka theksuar se është shqetësues numri në rritje i dhunës ndaj grave dhe fëmijëve. Gjatë kësaj jave nga data 25 deri më 29 tetor 2021, sa do të mbahet "Java për të Drejtat e Viktimave të Krimit", do të diskutohen temat si "Konfidencialiteti dhe ruajtja e privatësisë së viktimave të krimit", "Reagimi institucional, koordinimi dhe zbatimimi i dispozitave dhe politikave kundër trafikimit të njerëzve" dhe "Trajtimi i kryesve të dhunshëm me varësi nga droga, alkooli dhe me probleme të shëndetit mendor".



Një i vdekur dhe tre të infektuar me Covid në 24 orët e fundit

Prishtinë, 25 tetor (ER) - Në Kosovë u raportua të hënën një viktimitë nga Covid-19. Në raportin ditor të Ministrisë së Shëndetësisë bëhet me dije

edhe për tri raste të reja të të infektuarve. Rastet e reja pozitive rezultuan pas testimit të 1 298 mostrave. Në 24-orëshin paraprak, 20

pacientë u konfirmuan si të shëruar. Aktualisht raste aktive me koronavirus janë 438. Fushata e vaksinimit në Kosovë ka nisur në muajin

mars. Deri të hënën janë dhënë mbi 1.5 milion vaksina. Numri i qytetarëve të vaksinuar plotësisht ka kaluar 703 000.



Rriten çmimet e produkteve ushqimore në Kosovë, rëndohet buxheti familjar

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 25 TETOR - Ditët e fundit është vërejtur rritje e theksuar e çmimeve për produktet bazë të konsumit. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), norma vjetore e inflacionit në muajin shtator ka arritur në 4.9 për qind. ASK-ja thotë se Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është rritur kryesisht te produktet e mishit, qumështit,

perimet, uji e lëngjet, lëndët djegëse dhe shërbimet hoteliere. "Bukë dhe drithëra 1.5 për qind, mish 1.9 për qind, qumështi, djathi dhe vezët 7.7 për qind, vajrat dhe yndyrat ushqimore 28.2 për qind, perimet 19.7 për qind, sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsira 2.1 për qind, pijet alkoolike 3.8 për qind, duhani 2.7 për qind, gazi 10.6 për qind, lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet 4.6 për qind, karburantet dhe lubrifikantet

për pajisjet e transportit personal me 26.7 për qind, shërbime për transport me 2.2 për qind, shërbime telefonike dhe të telefaksit 20.3 për qind, pushime të organizuara turistike 8.9 për qind, shërbimet hoteliere 2.3 dhe shërbimet financiare 6 për qind", thuhet në raportin e kësaj agjencie. Sipas ASK-së, një litër vaj ushqimor në muajin shtator 2020 kushtonte 1.06 euro, ndërsa një vit më vonë ky produkt shitet për 1.55 euro.

Gjatë shtatorit të vitit të kaluar një kilogram oriz ka kushtuar 1.38 euro, kurse sivjet blihet për 1.44 euro, kurse 30 copë vezë gjatë muajit shtator janë shitur 2.61 euro nga 1.95 euro. Qytetarët këto rritje i kanë shpjeguar si katastrofale për të gjithë, duke thënë se rritjet nuk mund të mbulojnë me paga të tilla në nivel vendi edhe në kohë pandemie. E disa të tjerë thonë që kjo është rritje e çmimeve botërore, mirëpo në Kosovë nuk do të duhej të ndodhte për

shkak se ka me vite që pagat dhe pensionet nuk janë ngritur. Përveç këtyre rritjeve në produkte ushqimore, është paralajmëruar edhe rritja e çmimit të faturave të energjisë elektrike. E për këtë gjë qytetarët që ngrohen me rrymë thonë që do ta kenë shumë të vështirë pasi që do t'u duhet ta ndërrojnë komplet sistemin e ngrohjes, nga ajo me rrymë ta bëjnë me lëndë të tjera djegëse, sepse nuk mund t'i përballojnë kostot.



Çmimet e energjisë elektrike dhe të naftës po vazhdojnë të rriten në botë

BERLIN, 25 TETOR - Çmimet e energjisë elektrike, gazit dhe naftës po rriten gjithnjë e më shumë. Edhe konsumatorët gjermanë ndeshen me fatura të larta. Problemi është se nuk pritet ndonjë përmirësim i shpejtë. Ndër të paktat gjëra që i bëjnë gjermanët të humbasin qetësinë janë çmimet e larta të benzinës dhe naftës. Çmimi i naftës së fundmi është rritur më shumë se kurrë më parë. Pritet që së shpejti këtë ta pasojë çmimi i benzinës. Së shpejti ndoshta do të përmbushet një ëndërr e vjetër e Të Gjelbërve, se çmimi i benzinës duhet të

kushtojë 5 marka [2.5 euro] litri, kështu e vendosën dikur Të Gjelbrit në një kongres të tyre para 23 vjetësh, për ta bërë përdorimin e automjetit te gjermanët të papërbalueshëm. Por ky hap nuk u prit mirë, me zor atëherë kjo parti ia doli të hynte në Bundestag. Një episod gati i harruar, ndërkohë që tani Të Gjelbrit ndodhen para momentit të futen në qeveri për herë të dytë në historinë e tyre. Por situata këtë herë është shumë më ndryshe. Pandemia nuk ka marrë ende fund, efektet ekonomike të saj (duke hequr mënjane ato shëndetësore) janë



të jashtëzakonshme. Çmimet e larta të energjisë janë një pjesë e tyre. E aspak vetëm në Gjermani, por në të gjithë botën. Gjë që thjesht e në radhë të parë lidhet me atë, që ekonomia botërore, me gjithë pandeminë në vazhdim, po rimëkëmbet më shpejt se pritej. Me pasojë një rritje të jashtëzakonshme të urisë për energji, e dimë një kërkesë e fortë rrit çmimet. Por si këtë herë nuk ka ndodhur kurrë, vetëm çmimi i shumicës te gazi është rritur këtë vit 44 për qind. Edhe çmimi i naftës është rritur në nivele të larta duke u dyfishuar brenda një viti. (dw)

Sërish protestojnë punëtorët e Lotarisë së Kosovës

PRISHTINË, 25 TETOR - Mbi 60 punëtorë të Lotarisë së Kosovës kanë protestuar edhe këtë të hënë para objektit të Qeverisë së Kosovës. Punëtorët po kërkojnë ndryshimin e Ligjit për Lotarinë e

Kosovës dhe marrjen e pagave. Ata, po ashtu, kërkojnë që të rikthehen në punë meqë tash e sa kohë janë të papunë. Kryetari i Sindikatës së Lotarisë, Shkumbin Goçi, i cili tregoi për

arsyen e protestës, ka theksuar se kanë kërkuar takime me përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, por kjo kërkesë nuk është marrë parasysh. Ai ka shtuar se nuk do t'i ndalin

protestat derisa kërkesat e tyre të gjejnë zbatim. Para dy vjetëve Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Mbylljen e Lojërave të Fatit, ligj ky i cili hyri në fuqi më 10 maj 2019.





Kopshti i kënaqësive tokësore

Nga: Bledar KURTI

Nëse ka një vepër arti, e cila ka trazuar kritikën artistike dhe ka sfiduar imagjinatën e historianëve, analistëve dhe artdashësve në mbarë botën për pesë shekuj me radhë kjo vepër është Kopshti i kënaqësive tokësore (1505), nga artisti holandez Hieronymus Bosch (1450-1516). Kjo vepër, tërësisht surreale dhe futuriste të shtyn të spekulosh se udhëtimi në kohë është i mundur. Kur shohim figurat dhe kompozimin në këtë tablo gati-gati tundohe mi të imagjinojmë se një artist surrealist i shekullit XX ka udhëtuar pas në kohë në shekullin e XV-të dhe ka krijuar këtë vepër tronditëse dhe ngjethëse. Sigurisht që udhëtimi në kohë është i pamundur për artistët por jo i pamundur për artin, sepse arti qëndron përtej kohës, dhe kjo vepër është dëshmia më e mirë e këtij atributi të artit, i cili kapërcen shekuj si në të ardhmen ashtu edhe në të shkuarën, duke i shpalosur njerëzimit imazhe dhe botë të paimagjinueshme. Edhe sot, nëse i kërkon një njeriu, sado i edukuar a arsimuar qoftë ai apo ajo, e me sado imagjinatë të shfrenuar, të përfytyrojë një vepër me trupa njerëzorë që dalin nga guaskat; me kafshë e egërsira të llojeve të ndryshme që përzihen, çiftohen, vrasin, puthin, ushqejnë, trembin, dashurojnë,

frikësojnë apo drejtojnë njerëzit; me trupa njerëzorë që kalërojnë mace, tigra, deve, dhe peshq; njerëz lakuriq që marshojnë brenda lëvozhgave të vezës; partitura muzikore në mollaqet e njeriut; bimë e zogj që dalin në fluturim prej anusit; bufë të heshtur e të frikshëm që dëgjojnë e vështrojnë me një heshtje mortore; një njeri porsitruang peme të njehsuar me lëvozhgë veze; bretkosë mbi kraharorin e një femre dhe lejlekë mbi krye njerëzish; zvarranikë me tri koka; gjymtyrë të amputuar të varura në çengelë; vegla muzikore që lëshojnë terror ferri; lakuriqë nate dhe derra me veshje murgeshe; minj që frikësojnë njerëzit përmes cilindrave të qelqtë; çifte dashnorësh brenda filluskave e placentave bimore; luleshtrydhe që pluskojnë me krahë fluturash; e kompozime të pazakonta që duket sikur burojnë nga makthet më të tmerrshme të një gjumi të trazuar, përsëri do e ketë të pamundur t'i afrohet kësaj tabloje. Ajo çfarë e bën edhe më turbulluese këtë vepër është edhe informacioni i paktë që kemi për artistin, vitin dhe titullin e veprës. Nuk dihet me saktësi se kur lindi Bosch, por vetëm viti i tij i vdekjes. Dimë që ai ishte artist i Rilindjes së hershme holandeze, vinte nga një familje e pasur dhe se ishte shumë i lidhur me shtresën e lartë dhe kishën në qytetin e tij. Bosch i përkiste periudhës së

Rilindjes por, ndryshe nga Leonardo da Vinci, ai nuk ishte njeriu i gjithanshëm i Rilindjes; ai nuk udhëtoi jashtë qytetit Hertogenbosh, ku ai ishte një figurë me rëndësi të madhe e ku respektohej shumë si artist, e as nuk eksperimentoi me shkencën apo inxhinierinë, me anatominë njerëzore apo me mjetet me të cilat punonte. Nuk u mor nën patronazh nga oborre mbretërore por pikturoi kryesisht për porositës kishtarë dhe madje u bë anëtari një vëllazërie fetare. Nuk gjendet asnjë vepër laike në repertorin e pikturave të tij. Vetëm 25 vepra kanë mbetur sot nga ajo krijimtari. Titulli origjinal i kësaj veprë nuk dihet, por pasi u quajt si Tabloja e luleshtrydheve gjatë shekullit të 17-të, më vonë nisi të njihet si Kopshti i kënaqësive tokësore, dhe për shkak se vepra ka të pikturuar një frutë ananasi, i ardhur në Evropë pas zbulimit të Amerikës nga Christopher Columbus, besohet se vepra është kryer rreth vitit 1505. Vepra është e pikturuar mbi një panel triptik druri lisi, që do të thotë një vepër që hapet e mbyllet me dy dritare ose kanata. Kur vepra mbyllet, mbi të dallohet një kupë qiellore e përshkruar si glob i madh, me ngjyrë të errët, me nivele të ndryshme të hije-dritës. Në qoshen e majtë të sipërme të veprës vërehet Perëndia me një libër në dorë i cili po krijon kupën qiellore dhe mbarë botën. Në krye dallohet një

shkrim latin i bazuar mbi vargun e Psalmit 33:9 në Dhiatën e Vjetër: "Ai foli, dhe gjëja u bë; Ai urdhëroi dhe toka u shfaq." Kur kanatat mbyllen sfera duket perfekte, dhe brenda saj dallohet ndarja e ujërave dhe tokës, drita nga errësira, dhe formimi i dheut e qiellit. Kjo skenë e jashtëzakonshme ilustron momentin e krijimit të gjithësisë, e përshkruar tek libri i Zanafillës: Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën. Toka ishte pa trajtë, e zbrazët dhe errësira mbulonte sipërfaqen e humnerës; dhe Fryma e Perëndisë fluturonte mbi sipërfaqen e ujërave. Pastaj Perëndia tha: "U bëjtë drita!". Dhe drita u bë. Dhe Perëndia pa që drita ishte e mirë; dhe Perëndia e ndau dritën nga errësira. Dhe Perëndia e quajti dritën "ditë" dhe errësirën "natë". Kështu erdhi mbrëmja e pastaj erdhi mëngjesi: dita e parë. Pastaj Perëndia tha: "Le të jetë një kupë qiellore mes ujërave, që t'i ndajë ujërat nga ujërat". Dhe Perëndia krijoi kupën qiellore dhe ndau ujërat që ishin poshtë saj nga ujërat që ishin sipër saj. Dhe kështu u bë. Dhe Perëndia e quajti kupën qiellore "qiell". Kështu erdhi mbrëmja, pastaj erdhi mëngjesi: dita e dytë. Pastaj Perëndia tha: "Ujërat që janë nën qiellin të grumbullohen në një vend të vetëm dhe të shfaqet tera". Dhe kështu u bë. Dhe Perëndia e quajti terën "tokë" dhe

grumbullimin e ujërave "det". Dhe Perëndia pa që kjo ishte mirë. Pastaj Perëndia tha: "Të mbijë toka gjelbërimin, barërat të nxjerrin farë dhe drurët frutore të japin në tokë një frut që të përmbajë farën e tij, secili sipas llojit të tij". Dhe kështu u bë. Dhe toka prodhoi gjelbërim, barëra që e bënë farën sipas llojit të tyre dhe drurë që mbanin fruta me farën e tyre brenda, secili sipas llojit të vet. Dhe Perëndia e pa se kjo ishte mirë. Kështu erdhi mbrëmja, pastaj erdhi mëngjesi; dita e tretë. Pastaj Perëndia tha: "Të ketë ndriçues në kupën qiellore për të ndarë ditën nga nata; dhe të shërbejnë si shenja, për të dalluar stinët, ditët dhe vitet; dhe të shërbejnë si ndriçues në kupën qiellore për të ndriçuar tokën". Dhe kështu u bë. Perëndia krijoi pastaj dy ndriçues të mëdhenj: ndriçuesin e madh për qeverisjen e ditës dhe ndriçuesin e vogël për qeverisjen e natës; ai krijoi gjithashtu yjet. Dhe Perëndia i vendosi në kupën qiellore për të ndriçuar tokën, për të qeverisur ditën dhe natën dhe për ta ndarë dritën nga errësira. Dhe Perëndia e pa që kjo ishte mirë. Një shikues i fundit të viteve 1490-të apo fillim të viteve 1500-të do mahnitej me këtë kupë qiellore, e madje edhe njeriu modern yshtet nga kjo sferë perfekte që shpalos mjeshtërisht momentin e krijimit të gjithësisë. Por

imagjinoni pak habinë e shikuesit të asaj kohe kur janë hapur përpara syve kanatat e veprës triptike. Ai moment duhet të ketë qenë një përjetim imagjinar edhe më magjik se ai i Liza në Botën e Çudirave. Edhe njeriu modern, pavarësisht librave me aventura dhe filmave të shumtë fantashkencë vazhdon e tronditet mrekullisht nga kompozimi brenda kësaj veprë.

Ngjyrat e errëta të kupës qiellore mbi kanatë shërbejnë si një ilustrim i qëllimshëm për ngjyrat e ndezura që shpalosen përbrenda. Ballina është e pikturuar në monokrom, një teknikë që përdoret për të përshkruar një pikturë të ekzekutuar tërësisht në tonet e ngjyrave gri ose transparente. Ishte e zakonshme për veprat e altarit në Holandën e kohës që të pikturoheshin në monokrom në panelet e jashtme, si një dredhi për të krijuar një kontrast të madh me ngjyrat e gjalla në brendësi.

Bosch e ka konceptuar veprën porsori një libër. Në fillim ai donte shikuesin të yshtej nga ballina mistike e më pas të tronditej nga imazhet surreale që shpalosen përmes detajeve më të imta dhe figurave më të çuditshme që mund të perceptojë mendja njerëzore. Pjesa e brendshme e veprës është e ndarë në tri skena. Të trija të ndërlydhura nga i njëjti horizont e trajtim ngjyrash e figurash. Në koncept ato ndajnë emëruesin e përbashkët të mëkatit, i cili fillon në Parajsën ose Kopshtin e Edenit në skenën e majtë, zhvillohet përmes shthurjes së njerëzimit, dhe merr dënimin në Ferr në skenën e djathtë.

Në skenën e parë në të majtë të veprës është Kopshti i Edenit në momentin e sapo rënë në mëkat. Peizazhi është i përsosur e me ngjyra të shndritshme, por dallohet një trazirë tek kafshët, disa prej të cilave dalin në lloje të frikshme nga një gropë e errtë e tokës. Ato janë pikturuar armiqësore, duke ngrënë njëra-tjetrën, e madje edhe me tri koka. Arsyja e trazisë dallohet në qendër të figurës ku dallohet Krishti i cili tekta cek prej dore Evën ia paraqet atë Adamit, njeriut të parë, dhe ai moment simbolizon mosbindjen e tyre ndaj urdhrut të Perëndisë për të mos ngrënë nga pema e jetës. Ai është momenti i rënies së njeriut, i ardhjes së mëkatit në botë, i ndryshimit të rendit natyral. Përpara rënies nuk kishte armiqësi as tek kafshët, por nga bar-ngrënëse ato nisën të hanin njëra-tjetrën. Rendi u përmbys. Natyra e përsosur e qenieve dhe gjallesave u zhbë.

Kopshti i Edenit ka marrë një pamje të re pas rënies. Në krye të skenës dallohet lumi me katër degëzime, i përshkruar si shatërvani i ujit të përjetshëm, në të djathtë të së cilit vërehet një figure surreale që ka një sy me qerpikë të gjatë e të shkrirë

porsori orët e Salvador Dali disa shekuj më vonë. Madje edhe e gjithë fytyra ngjason me fytyrën dhe mustaqet e Salvador Dali. Gjithashtu në këtë skenë dallohet një kalë njëbrirësh dhe kafshë të tjera hibride të panjohura për nga lloji, së bashku me zogj, peshq, krijesa të tjera ujore, gjarpërinj dhe insekte.

Me ardhjen e mëkatit, njeriu dhe bota u gjendën në një realitet të ri, në atë të vdekjes. Nga të pavdekshëm tashmë vdekatarë Adami dhe Eva sollën rendin e ri të një bote të rënë. “Toka do të jetë e mallkuar për shkakun tënd. Ajo do të prodhojë gjemba dhe bimë gjembore, dhe ti do të hash barin e fushave, dhe do të hash bukën me djersën e ballit, deri sa të rikthehesh në dhe sepse nga ai ke dalë, sepse ti je pluhur dhe në pluhur do të rikthehesh,” ishte dënimi i Perëndisë për njeriun, pasojat e së cilit dallohen në skenat e tjera.

Nga rënia e njeriut dhe Eden-i mëkatar, syri kalon tek qendra e veprës, tek skena e dytë, e cila përshkruan shthurjen e njerëzimit. Qendra e tablosë është më tronditëseja e gjithë veprës. Me qindra figura meshkujsh e femrash të bardhë e të zinj, kafshësh e shpendësh, e krijesash të ferrta janë përshkruar plot harbim, kurvëri dhe shthurje.

Në panelin qendror gjendet një numër i madh figurash të zhveshura njerëzore, me përjashtim të çiftit në të djathtën e poshtme, të cilët identifikohen si Adami dhe Eva pas dëbimit nga Parajsa. Burrat dhe gratë, të racave të zeza dhe të bardhë, janë në grupe ose çifte, duke kryer marrëdhënie dashurie (në disa raste të një natyre të ndaluar) me një nuancë të fuqishme erotike që i referohet temës së mëkatit të epshit. Kafshët, si të vërteta ashtu edhe imagjinare, janë shumë më të mëdha se shkalla normale. Kjo ilustron zhbërjen e rendit të natyrës të krijuar prej Perëndisë. Midis tyre, Bosch thekson dy lloje të ndryshme bufësh që ngjallin të ligën dhe të keqen. Duke shikuar drejt, ata hedhin vështrimin e tyre të frikshëm tek shikuesit, në të dy skajet anësore të panelit, të vendosur mbrapa dhe jo në plan të parë, e duke na treguar se në heshtjen e tyre frikësuese ata dëgjojnë dhe shikojnë çdo gjë. Gjithashtu vërehen edhe bimë dhe fruta, të cilat janë gjithashtu shumë më të mëdha se dimensionet e tyre normale.

Vepra përmban shumë fruta ngjyrë të kuqe dhe blu. Disa janë të panjohura, por luleshtrydhet, qershitë dhe manaferrat janë më të dalluarat. Të gjitha këto janë fruta afrodisiakë të cilat nxisin epshin seksual. Ato simbolizojnë kënaqësitë momentale. Harbimi dhe epshi i shfrenuar u përshkrua nga Bosch tek pellgu me ujë i mbushur me gra të

zhveshura rreth së cilave vërtiten duke kalëruar në drejtim të kundërt të orës një grup njerëzish hipur mbi kafshë të ndryshme, disa prej tyre ekzotike apo imagjinare.

E gjithë skena është epshore. Kafshët dhe njerëzit garojnë se cila prej tyre do tregohet më kafshore sesa tjetra, të ndërlydhura në një brutalitet dhe atmosferë halucinante. Trupat e zhveshur dhe frytet e shpërndara na shpalosin epsh e grykësi, ndaj edhe mendja menjëherë na shkon tek shtatë mëkatet vdekatare, një listë mëkatesh të konsideruara më të rëndat në besimin e krishterë katolik: krenaria, babëzia, epshi, zilia, grykësia, zemërimi dhe përtacia. Nëse vëzhgojmë me kujdes të gjitha figurat do i dallojmë këto mëkate të shpërndara në qendrën e tablosë.

Skena zhvillohet në Eden por ajo nuk ka asnjë kuptim logjik. Pikërisht këtë kërkonte të shpaloste Bosch, rënia e logjikës dhe e rendit. Në krye dallohen katër degëzimet e lumit dhe në qendër dallohet globi mbi të cilin ka figura njerëzore me kokë poshtë të cilët ilustrojnë rënien e njeriut dhe rrëzimin e rendit të natyreshëm e hyjnor.

Në skenën tjetër gjendet shpërblimi për mëkatat e trupit. Skena e tretë është Ferri. Kundrejt një sfondi të errët, muret e qytetit të ngjashme me burgje janë skicuar në siluetë të zymtë kundër fushave të flakta. Trupat njerëzor grumbullohen ngado në grupe, ose me veshje ushtarake ose u nënshtrohen torturave makabër në duart e ekzekutuesve të çuditshëm dhe demonëve me figura kafshësh. Ferri përshkruhet edhe me disa instrumente të çuditshëm që grijnë mishin njerëzor; pajisje thikash e heshtash; kumarxhinj me zare dhe letra të shpartalluar; demonë në formë zvarranikësh e dragonjsh që ushqehen nga barku i një kalorësi; djalli me kokën e një zogu blu i cili kollofit një njeri, nga anusi i të cilit dalin fluturimthi zogj të zi; vegla muzikore të cilat simbolizojnë tërheqjen e së ligës, joshjen nga imoraliteti dhe thirrjen e kushtimit të vetëkënaqësisë. Në këndin e poshtëm dallohet një derr me veshje murgeshë që detyron një njeri të firmosë një dokument, me shumë gjasa të dorëzoi pasurinë e tij, duke simbolizuar kështu korrupsionin ndër klerin.

Por në qendër të skenës dallohet një trup porsori lëvozhgë e zbrazët veze, me këmbë pemësh të thata që pluskojnë mbi dy varka. Dhe koka e figurës është e vetmja fytyrë e pikturuar me një realizëm fanatik. Duke e krahasuar me portretin e Bosch nga artistë të mëvonshëm mendohet se kjo figurë është autoportreti i artistit. Ai duket i menduar dhe i dëshpëruar për gjendjen e njerëzimit. I pikëlluar për atë histori të rënies

tragjike nga lavdia në vdekje, nga liria në dënim. Ajo çfarë e përforcon më shumë teorinë se figura e burrit është autoportret është fakti se mbiemri i tij i vërtetë ishte Van Aken por ai zgjodhi Bosch sipas emrit të qytetit ku jetonte, dhe “den bosch” përkthehet “pyll”, dhe ai njihej si “njeriu i pyllit”, ndaj edhe duke parë trunget e pemëve si eshtra tek figura me trup veze, mund të pranojmë që kjo figurë është vetë artisti.

Në tërësi, vepra është një makth i mrekullueshëm dhe ëndërr artistike e një gjumi me sy hapur. Por mesazhi i saj ishte përtej estetikës apo mjeshtërisë piktoreske. Në Evropën e krishterë të kohës Zoti dhe djalli, e mira dhe e keqja, shpërblimi i virtytit dhe dënimi i vesit, ishin më se reale në jetën e njerëzve. Besimi ishte i rrënjësor në çdo aktivitet të jetës dhe shoqëronte njerëzit në çdo hap të ditës. Por, mësimet e krishtera bëheshin vetëm përmes Biblës në hebraisht dhe greqisht, apo shërbesat fetare në latinisht. Njerëzit e zakonshëm nuk mund ta lexonin dot Biblën ndaj ata përdornin piktura dhe ikona për të ilustruar historitë biblike. Ato shërbenin edhe si kujtesë për shikuesin se cila do ishte vendmbërritja e tij në jetën e përtejme, apo cili dënim e pret njeriun për mëkatet e tij, ndaj edhe kjo veprë u krijua si një kujtesë. Cilido që e porositi këtë veprë e përdorte atë si kujtesë e dënimit të mëkatit. Si një shuplakë për dhënien pas veseve, epshit, grykësisë, zilisë, krenarisë, babëzisë, zemërimit dhe përtacisë. Cilido që e kishte këtë veprë të varur në shtëpi do mendohej një mijë herë përpara se të jepej pas vetëkënaqësisë dhe dëshirave trupore. Sa herë që ai do tundohej të jepej pas ndonjë vesi menjëherë do i vinin në mendje zogjtë demoniakë, dashnorët e humbur të lakmisë, moria dhe togat e demonëve me torturat e tyre të liga, detet me jashtëqitje dhe organet e brendshme njerëzore të shndërruara në eshtra të tharë e çerdhe zogjsh, dhe njerëz që përpohen nga përbindësia të çdo forme, madhësie dhe lloji.

Kjo veprë, e madje të gjitha veprat e tjera të Bosch, shërben si një pasqyrë për të ndihmuar padronin e veprës të shihet veten më mirë. Bosch synonte t'i jepte mesazhin shikuesit dhe të gjithë familjes së tij se nuk duhet të jepej pas kënaqësisë, harbimit dhe shthurjes, të cilat do e çonin në ferr, por të zgjidhte rrugën e drejtë dhe të perëndishme. Të gjithë studiuesit pajtohen dhe drejtojnë gishtin nga fakti se në këtë periudhë ishte shumë e njohur lëvizja Devotio Moderna (Përkushtimi Modern). Kjo ishte një lëvizje fetare e cila besonte fuqishëm se njeriu duhet të mbante përgjegjësi për veprimet e tij. Çdo sjellje e tij e gabuar do

kishte pasoja dhe dënim. “Bëni, pra, të vdesin gjymtyrët tuaja që janë mbi tokë: kurvërinë, ndyrësinë, pasionet, dëshirat e këqija dhe lakminë, që është idhujtari; për këto gjëra zemërimi i Perëndisë vjen përmbi bijtë e mosbindjes,” predikohej në shërbesat fetare, ndaj është pikërisht ky mesazhi i Bosch për padronin e kësaj veprë dhe të gjithë familjen e tij: mos u jepni pas mëkatit pasi ju pret ferri.

Kjo ishte edhe arsyeja përse mbreti i Spanjës Filipi II e mori këtë veprë në vitin 1591 dhe e vari në dhomën e tij të gjumit, bashkë me vepra të tjera të Bosch si për shembull Shatë Mëkatet Vdekatare dhe Katër Gjërat e Përjetshme (1500), si kujtesë për ndëshkimet që e prisnin nëse do jepej pas vetëkënaqësive dhe dëshirave mishore. Ngjitur me dhomën e tij kishte një derë që të çonte në faltore. Çdo ditë mbreti, njeriu më i pushtetshëm në Spanjë e më gjerë, reflektonte e dridhej për dënimet e ferrit dhe më pas shkonte përtej derës e lutej në faltore.

Kur vepra u shpërngul në Museo del Prado në Madrid në vitin 1939, ajo frymëzoi artistët dhe shkrimtarët më të shquar të kohës si René Magritte, Max Ernst, Salvador Dali, Joan Miro, dhe surrealistë të tjerë. Madje edhe për shkak të kësaj veprë shkrimtari i njohur amerikan Ernest Hemingway u frymëzua për romanin e tij Kopshti i Edenit në të cilin shtjellohet rënia e rendit natyral njerëzor, sikurse tek vepra e Bosch. Gjatë qëndrimit dyjavor në Madrid në vitin 1953, Mary Hemingway, bashkëshortja e shkrimtarit, kujton se Ernest Hemingway kalonte një orë çdo mëngjes në Museo del Prado. “Në ditën e fundit të vizitës sonë në del Prado...”, shkroi Maria, “Ernest-i zbuloi një zog pupëz në pikturën e Hieronymus Bosch, Kopshti i Kënaqësive Tokësore. Në të gjithë Madridin, asgjë tjetër nuk e kënaqi atë më shumë sesa ky zbulim.” Edhe ky detaj, në dukje kaq i parëndësishëm, shërben për interpretimin e veprës pasi zogu pupëz përmendet në Dhjatën e Vjetër tek lista e zogjeve që Perëndia urdhëroi izraelitët të mos e hanë pasi është shpend i papastër, bashkë me bufin, lejlekun dhe lakuriqin e natës, të gjitha këto shpendë të pikturuara në veprën e Bosch. Kësisoj bëhet e qartë që artisti ka pikturuar qëllimisht gjërat më të papastra të natyrës dhe veseve të njeriut dhe dënimin e përjetshëm e të ferrtë që e pret cilindo që i kryen ato.

Vepra Kopshti i kënaqësive tokësore është një kryevepër e cila mahnitë shikuesit e pesë shekujve më parë, vazhdon të na frikësojë e yshtë edhe sot, e pa asnjë dyshim do magjepsë dhe ngashënjëje edhe shikuesit e epokave të ardhshme. Kjo është forca dhe atributi i artit. /Gazeta “ExLibris”/

PROF. DR. EQREM ZENELAJ DEKOROHET NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË SH.T. Z. ILIR META ME TITULLIN 'KALORËS I URDHËRIT TË SKËNDERBEUT'

Shkencëtari Atdhetar, Prof. Dr. Eqrem ZENELAJ 'Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut'



Nga: Ing. Kol DEDAJ
- studiues -

Tiranë më, 14.10.2021, pata fatin të jem i ftuar nga miku im, shkencëtari Atdhetar Prof. Dr. Eqrem Zenelaj me rastin e dekorimit të tij nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë SH.T.Z. Ilir Meta, i cili në sëlinë e preridencës i dorëzoi titullin e lartë " Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut" të akorduar me dekret nr.13267, datë 13.10.2021, me motivacionin: *Në vlerësim të kontributeve të pa kursuera në fushen e studimeve dhe botimeve për pasqyrimin e historis së popullit shqiptar dhe prejadhjes sonë iliro-pellazge. Në mirenjohje për punën e vazhdueshme në promovimin e vlerave kombëtare të popullit shqiptar, si dhe për kontributin në fushen e studimeve albnologjike dhe për veprimtarinë e nivelit të lartë në shërbim të historis sonë kombëtare.* Në këtë ceremoni morën pjesë, studiues, pedagog, profesor, akademik, koleg, miq, të afërme e familjar të zotit Eqrem Zenelaj nga Shqipëria, Kosova e më gjërë. Studimet e Profesor Eqrem ZENELAJ-t, janë një burim pa fund dijeshe, për vlerat nga më të lartat dhe dinjitetin e jashtëzakonshëm të kombit tonë dhe përbëjnë një horizont të ri njohurish, për çdo lexues në tërësi, por për studiuesit në veçanti, ato janë një thesare i vërtetë akademik, sikurse do ta cilësonte shtypi i kohës. Hulumtuesi Hazir Mehmeti, në librin e tij: Studiues Austriak dhe shqiptar në Austri, Prof. Dr. Eqrem Zenelaj do ta vendoste në ballinën e këtij libri krahas kollosëve të letrave shqipe si: Eqrem Çabej, Gjergj Pekmezi, Pandeli Sotiri, Norbert Jokl, Hil Mosi, Lasgush Poradeci, Xhevat Korça, Eqrem Vlora, Marie (Paluca) Kraja, Aleks

Buda, si dhe miku i shqiptarëve, mbështetësi i Pavarësisë së Shqipërisë Kancelari i Austro-Hungarisë dhe Ministër i Jashtëm Konti Berchtold (Berhtold) dhe Ismail Qemal Vlora (Ismail Qemali). Të shumta janë vlerësimet për të nga personalitete të njohura



'Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut'



Prof. Dr. Eqrem ZENELAJ
"Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut"

akademike e kombëtare, të tilla si: Me librin Pellazge-ilirët-Shqiptarët, Pof. Dr. Eqrem Zenelaj lëkund rrënjët e historografisë së gjithë botës (*Berat Armagedoni*, "Epoka e Re", 2017, f.13); Prof. Dr.

Eqrem Zenelaj, një studiues i përkushtuar ndaj kombit të tij (*Darling Ismail Vlora-Sternip i Ismail Qemalit, Epoka e Re, 08.10.201, f.11*); "Pas, Aleks Budes, Vjena na dha Eqrem Zenelaj" (*Prof. Dr. Selim Daci, "Koha Ditore" Prishtinë 2016, f.30*); Veprat e Prof. Eqrem Zenelaj janë një akademi më vete (Mag.sci.Hazir Mehmeti-Ambasador Nderi i Vjenës, Veprimtar dhe autor i shumë librave, "Epoka e Re" f.13, 03.11.201, f.13); Një libër i veçantë me vlera të mëdha arkivore, shkencore kombëtare dhe historike (*Prof. Dr. Muhamet Mala-Vice Rektor i Universitetit të Prishtinës, Epoka e re, 01.10.2010, f.13*); Nuk kam njohur një të dytë shkencëtar si profesor Zenelaj (*Dr. Vili Minaraolli-Ish-Ambasador i Shqipërisë në Vjenë "Epoka e Re", viti 2015f.12*); Libri Pellazget-ilirët-shqiptarët, një vepër e rrallë dhe autori Prof. Dr. Eqrem Zenelaj njeri me kredibilitet Shkencor (*Prof. Dr. Mazlum Baraliu, Epoka e Re, viti 2018; Pellazget Ilirët Shqiptarët ia shton krenarinë kombëtare çdo shqiptari (Dr.Roland Bimo-Ambasador i Shqipërisë në Vjenë),etj.*

2 - JETËSHKRIM PËR PROF. DR. EQREM ZENELAJ

Prof.dr.Eqrem Zenelaj (Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut), u lind në Grajkoc të Therandës, në Dardani (Kosovë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen (gjimnazin) në Therandë, kurse studimet universitare në Universitetin e Prishtinës. Në Fakultetin Filozofik mori titullin shkencor Prof. Dr. Filozofi-Sociologjisë, ndërsa në Fakultetin Juridik mori titullin e Magjistratit të Shkencave Politike Juridike. Pasi mbaroi studimet pasuniversitare në Prishtinë, Eqrem Zenelaj u regjistrua në Universitetin e Vjenës (Haupt universität-Alma Mater Rudolphina-Èien) në Austri. Në Universitetin publik (shtetror) të Vjenës Zenelaj mori titullin shkencor të Doktorit të Shkencave Juridike (dr. iur.) nga



Prof Dr. Eqrem Zenelaj dhe Presidenti i Shqipërisë SH.T. Z. Ilir Meta

lëmi i së Drejtës Ndërkombëtare Publike. Pas mbarimit të doktoratës së parë, filloi specializimin për të Drejtën Evropiane në qytetin Krens të Austrisë së Ulët (Donau-Universität), për ta vazhduar në Vjenë dhe për ta përfunduar në qytetin Nica të Francës, duke marrë titullin "Ekspert për të drejtën e Unionit Evropian". Eqrem Zenelaj ka vijuar dy vjet për një specializim tjetër për të Drejtën Gjermane (Deutsches Recht) në qytetin Passau të Gjermanisë. Po ashtu, ka filluar studimet e doktoratës së dytë nga lëmi i Historisë Mesjetës në Universitetin e Vjenës (Hauptuniversität-Alma Mater Rudolphina) në Austri, në të cilin i ka përfunduar provimet, kurse

tani është duke punuar temën e diplomës. Eqrem Zenelaj është hulumtues i pasionuar i 20 arkivave të vjetra evropiane, ndërsa për 24 vjet të hulumtimeve arkivore ka zbuluar dhe grumbulluar rreth 5 000 dokumente të vjetra arkivore me rëndësi historike e kombëtare, shumica e të cilave zbulohen dhe publikohen për herë të parë. Ai, deri më tani i ka botuar 12 libra: - Historia e shtetit dhe e së drejtës shqiptare (nga mbretërit pellazgë e ilirë e deri te Mbreti Zogu I); - E drejta diplomatike e konsullore; Historia e diplomacisë; Diplomacia e Ismail Kemal Bej Vlorës, rivalitetet e brendshme në Shqipëri dhe rruga e Pavarësisë 1911-"12; Çështja shqiptare nga këndvështrimi i



Prof. Asoc. Dr. Eqrem Zebelaj dhe Rektori i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren Prof. Asoc. Dr. Samedin Krraba dhe Prorektorja Prof. Ass. Dr. Albana Plakiqi - Misini

diplomacisë dhe i gjeopolitikës së Austro-Hungarisë (1699-1918); Gjenealogjia e familjes Albani nga Urbinodhe Bergamo të Italisë, Papa shqiptar "Klemens XI-Albani"; Shtypi i Austrisë për demonstratat e shqiptarëve të Kosovës më 1968, 1981 dhe 1989; - Bazat e diplomacisë; Pellazgët-Ilirët-Shqiptarët, botimi i parë 2017 dhe botimi i dytë 2021; - Album historik Kombëtar, Gjergj Kastrioti- Skënderbeu; Lufta e Trojës si pas Diktit të Kretës dhe Darit të Frigjisë (De Bello Trojano-Dictys Cretensis & Dares Phrygijs).

Shumica e librave të tij kanë recensentë të njohur ndërkombëtarë (si: Univ. Prof. Dr. Peter Fischer, Univ. Prof. Dr. Richard Potz, Univ. Prof. Dr. Leopold Auer etj.) Deri më tani Profesor Zenelaj ka hapur shtatë ekspozita me gravura të vjetra, fotografi, dokumente dhe materiale të vjetra arkivore me rëndësi historike e kombëtare: I. E para ekspozitë është hapur në 540 vjetorin e vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në Galerinë e Arteve të Kosovës nën përkujdesjen e ish-presidentit të Kosovës, Prof. Dr. Fatmir Sejdiu.II. E dyta është hapur në një vjetorin e Pavarësisë së Kosovës në Muzeun Kombëtar në Prishtinë nën përkujdesjen e



Ing. Mihallaq Hanxhari dhe Prof. Dr. Eqrem Zenelaj

përkujdesjen e kryebashkiakut Lorenc Luka. VI. E gjashta është hapur në qytetin e Tetovës nën përkujdesjen e kryetares së Komunës së Tetovës, Prof. Dr. Teuta Arifi; VII. E shtata, është hapur në Muzeun e Kosovës në Prishtinë nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës Ramush Haradinaj dhe Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës me në krye drejtorin Ramë Manaj. Eqrem Zenelaj, ka punuar një vit në Gjykatën Supreme të Austrisë në Vjenë në cilësinë e juristit praktikant, ndërsa disa vjet ka qenë anëtar dhe bashkëpunëtor i Institutit të Evropës së Mesme dhe Hapësirës së Danubit me seli në Vjenë (IDM INSTITUT-Ëien), nën udhëheqjen e Dr.Erhard Busek, është bashkëpunëtor i Institutit Albanologjik të Prishtinës, bashkëpunëtor i Qendrës së Studimeve Albanologjike (QSA) në Tiranë dhe bashkëpunëtor i shumë gazetave ditore e javore e revistave shkencore në Kosovë. Eqrem Zenelaj ka ligjruar në Universitetin Publik të Prishtinës, pastaj në disa kolegeje universitare private, tani është ligjruar i rregullt në Universitetin Publik "UkshinHoti" në Prizren. Lëndët profesionale të cilat i ligjëron Prof.dr.EqremZenelaj janë: E drejta ndërkombëtare publike; E drejta humanitare ndërkombëtare; E drejta diplomatike e konsullore; E drejta Evropiane; Marrëdhënie ndërkombëtare; Politikat dhe institucionet e Unionit Evropian; Historia e shtetit dhe së drejtës shqiptare, si dhe Fillet dhe Filozofia e së Drejtës.

Prof. dr. Eqrem Zenelaj punon në Kosovë, ai është i martuar me Ing.Kada Zenelaj (Maloku) dhe ka gjashtë fëmijë, katër vajza e dy djem: Njomzën; Adelinën; Hajrijen; Edionisën; Enisin dhe Elvisin, ndërsa që 25 vjet jeton bashkë me familjen në Vjenë të Austrisë.



Prof. Dr. Eqrem Zenelaj dhe Ing. Sazan Guri

3 - TITUJ NDERI, ÇMIME DHE VLERËSIME

Vepra dhe veprimtaria e profsor Zenelaj-t, është vlerësuar nga shumë akademi dhe institucione të tilla si:

- "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut" nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë SH.T.Z. Ilir Meta, të akorduar me dekret nr. 13267, datë 13. 10. 2021; - Mjeshtër i madh i albanologjisë,

Zym,Kosovë.

- Mirënjohje nga Komuna e Tetovës në krye me Prof.dr.Teuta Arifin;- Mirënjohje nga Ish-Kryetari i Bashkisë së Shkodrës z.Lorenc Luka dhe shumë mirënjohje të tjera.

Duke lexuar veprat e tij, si dhe kryeveprën e Historisë Kombëtare Shqiptare: "Pellazgët-ilirët-shqiptarët" të Profesor Eqrem Zenelaj-t, shifet se ky "erudit" ndjen thellë dhe pa rreshtur në



Ing.Kol Dedaj (Pukë), Prof. Dr. Eqrem Zenelaj dhe atdhetari mirditor Dod Luli

nga Akademia alternative: "Rrënjët tona", Tiranë

- Mirënjohje, nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës;- Mirënjohje, nga Unioni i Shkrimtarëve të Kosovës - Çmimi Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, nga manifestimi letrar, kulturor e shkencor, "Takimet e Gjecovit2018",


shpirtin e tij frymën shkencore e atdhetare shqiptare, "si një fill magnetik i cili përcjell genin" që ndërlidh epokat me iluminizmin tonë kombëtar, me mendje ndriturit: Pjetër Budi, Gjon Buzuku, Pjetër Bogdani, Frang Bardhi, Lekë Matrënga, dhe diplomatët e shquar Arbnorë: Vëllezërit Gzullorë, Helios Bossi-Berisha, etj., të Dukagjinit të vjetër (Pukës) prej nga vjen dhe origjia e tij.

Truallit tonë, tokës sonë amëtare, në çdo kohë të rrugëtimit të saj që në periudhat e lashtësisë së saj pellazgo-iliro-arbnore e deri në epokën tonë Shqiptare, ka pasur dhe ka ditur ti japë njerëzimit shkencëtar, atdhetar dhe misionar kombëtar të përmasave globale siç është edhe rasti aktual i "Kalorës-it të Urdhërit të Skënderbeut", prof. Dr. Eqrem Zenelaj (Paris Memaj).

Vepra dhe veprimtaria e tij shkencore e atdhetare e vendosë Prof. Dr. Eqrem Zenelaj ne "Panteonin e iluminizmit tonë kombëtar.



Mr. sci. Hazir Mehmeti (veprimtar) dhe Prof. Dr. Eqrem Zenelaj



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Çeku: Kosova do t'i ndjekë rrugët ligjore ndaj Serbisë

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrullah Çeku, ka paralajmëruar se Kosova do t'i ndjekë rrugët ligjore ndaj Serbisë. Ndërsa sekretari i Federatës së Boksit të Kosovës, Latif Demolli, pret që Serbia të dënohet me 10 vjet. Sipas tij, AIBA luajti me dy karta

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 TETOR - Shteti i Kosovës do t'i ndjekë rrugët ligjore ndaj Serbisë për moslejimin e pjesëmarrjes së boksierëve në Kampionatin Botëror që po mbahet në Beograd. Këtë lajm e ka bërë me dije ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrullah Çeku, në një konferencë për media. "Në emër të Qeverisë së Kosovës e dënojmë rëndë veprimin për ndalimin e pjesëmarrjes së boksierëve në Botëror. Konsiderojmë se ky veprim i

organizatorit është vendim i marrë nga direktivat e qeverisë serbe. Jam këtu para jush bashkë me përfaqësuesen tonë. Para dy ditëve MKRS-ja së bashku me Ministrinë e Punëve të Jashtme kemi drejtuar kërkesë zyrtare në MKRS të Serbisë për të tërhequr prapa iniciativën e tyre për bllokimin e delegacionit të Kosovës për të hyrë në Serbi. Ftesën për pjesëmarrje e kemi parë nga Federata Botërore e Boksit e jo nga shteti i Serbisë. Kemi kërkuar reagim edhe nga ambasadat e shteteve në Kosovë që me autoritetin e tyre të



ndërhyjnë", ka thënë Çeku. Numri një i MKRS-së ka bërë me dije se gjatë kësaj jave Kosova do të vendosë për ndalimin e zhvillimit të "aktiviteteve sportive paralele" serbe. Ndërsa sekretari i Federatës së Boksit të Kosovës, Latif Demolli, ka treguar se si ekipi i Kosovës nuk u lejua që tri herë të futet në Serbi. "Kemi qëndruar 12 ditë të izoluar. E kemi paraqitur ekipin një muaj më herët në AIBA dhe

Federatën e Serbisë dhe deri në ditën e fundit gjithçka në rregull. Ditën e parë kur jemi nisur, jemi ndaluar nga policia serbe dhe na ka thënë se me logon e Kosovës nuk mund të hyni në territorin serb. Unë i kam thënë se ne jemi të barabartë me të gjitha shtetet pjesëmarrëse. Jemi kthyer. Më pas na është thënë nga Komiteti Olimpik Kombëtar që të nisemi dhe prapë ndodhi e njëjta. Na kërkuar që të

shkonim pa simbole. Shkuam herën e tretë, pa simbole, policia serbe u soll shumë mirë, na kontrollon dhe na tha që të prisnim. Shefi i policisë u kthye pas një ore dhe na tha që kemi urdhër nga lart që të mos lejohet përfaqësimi i Kosovës brenda Serbisë", ka thënë Demolli, i cili ka akuzuar edhe AIBA-n që, sipas tij, ka "luajtur me dy karta". Ai pret një dënim prej 10 vjetësh pezullim për Serbinë. "Edhe AIBA ka luajtur me dy karta, pasi ditën e parë na tha të shkonim, më pas na tha t'i largonim simbolet. Tani këta boksierë do të duhet shumë që ta kthejnë formën. Do të kërkoj për këta boksierë që të kenë pikë për Lojërat Olimpikë 'Parisi 2024', pasi ky është synimi ynë dhe në këto gara merren pikët për të qenë në olimpiadë. Pres që Serbia të dënohet me 10 vjet pezullim apo më shumë, ashtu siç i ndodhi Indisë me Donjeta Sadikun", ka deklaruar Demolli.

Gjyqtari Beqiri delegohet nga UEFA për Ligën e Kampionëve në futsall



"Epoka e re"

PRISHTINË, 25 TETOR - Një lajm i mirë për sportin e Kosovës është se gjyqtari i futsalit, Besar Beqiri, është deleguar nga UEFA për ta ndarë drejtësinë në ndeshjen e

Ligës së Kampionëve. Lajmin e ka bërë me dije për "Epokën e re", Besar Beqiri. Ai është shprehur i lumtur se puna e tij po vlerësohet lart edhe nga UEFA. "Jam i deleguar në Slloveni për Ligën e Kampionëve ku marrin pjesë në grupin fitues aktual, Sporting

Lisbona nga Portugalia, Duboveci nga Slloveni, Atyra nga Kazakistani dhe Mcc nga Franca. Është maind round dhe ndeshje shumë të forta. UEFA më ka vlerësuar pasi jam ngritur në ranglistën për gjyqtar dhe tash kemi lojë më të forta për të gjykuar",

ka thënë Beqiri. Në muajin mars dhe prill Beqiri ka ndarë drejtësinë për kualifikimet e Evropianit në mes të Polonisë dhe Norvegjisë si dhe në ndeshjen Slloveni - Latvi. Besar Beqiri udhëton sot (e martë), kurse ndeshjet zhvillohen më 28 dhe 29 tetor.

Besa në raundin e tretë të Kupës Evropiane përballet me Potaissa Turda



PEJË, 25 TETOR - Kampionia e Kosovës në hendboll, Besa Famgas, do të takohet me skuadrën rumune Potaissa Turda në raundin e tretë të Kupës Evropiane. Shorti për raundin e tretë është tërhequr të hënën në Vjenë. Ndeshja e parë zhvillohet

më 27 apo 28 nëntor në Pejë, ndërsa e kthimit një javë më vonë në Rumani. Skuadra pejane Besa Famgas në raundin e dytë të Kupës Evropiane e eliminoi Borcin e Banjallukës. Ndeshjen e parë në Banjallukë Borci e kishte fituar me tri gola dallim, por të dielën në Pejë

Besa fitoi me shtatë gola dallim, 29:22. Skuadra nga Kosova tani e kërkon suksesin edhe në raundin e tretë, por nuk do ta ketë lehtë. Skuadra nga qyteti Turda ishte fituese e Kupës Sfiduese në vitin 2018. Potaissa Turda vjet ishte ndalur në raundin e dytë

kualifikues të Ligës Evropiane. Në vitin 2017 Turda ishte përballur me Trepçën dhe i kishte fituar dy ndeshjet në Mitrovicë. Është prej skuadrave më të forta në Kupën Evropiane, por pejanët do të japin më të mirën për ta kaluar edhe një skuadër të fuqishme.

'Dardanet' U19 humbin ndeshjen vendimtare ndaj Kroacisë

PRISHTINË, 25 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës U19 në konkurrencën e femrave ka pësuar humbje në ndeshjen vendimtare të Grupit 5 të Ligës B për kualifikimet e Kampionatit Evropian 2022. Pas fitoreve ndaj

Letonisë dhe Lihtenshtajnit, "Dardanet" U19 kanë pësuar humbje nga nikoqirja e ndeshjeve të këtij grupi, Kroacia, me rezultat të ngushtë 1:0. Golin e vetëm të kësaj ndeshjeje e realizoi Barbara Zhivković në

minutën e 36. Në vazhdim të ndeshjes, pavarësisht prej përpjekjeve maksimale për ta barazuar rezultatin, vashat e drejtuar nga Kushtrim Munishi nuk ia arritën qëllimit, duke i mbyllur këto kualifikime me 6

pikë në pozitën e dytë, teksa Kroacia e siguroi kalimin në Ligën A dhe pjesëmarrjen në fazën e radhës kualifikuese. Kalimin më tutje e siguron edhe vendi i dytë më i mirë nga gjashtë grupet e Ligës B.



Ronaldo: Tifozët tanë nuk e meritojnë këtë

MANCHESTER, 25 TETOR - Manchester Unitedi pësoi dje një humbje të rëndë 5-0 në "Old Trafford" ndaj një rivali historik si Liverpooli. Cristiano Ronaldo nuk mundi ta ndihmonte skuadrën e tij,

pasi një nga golat iu anulua për pozicion jashtë lojës. Portugezi ka reaguar në rrjetet sociale, duke motivuar shokët e tij të ekipit. "Ndonjëherë rezultati i ndeshjes nuk është ai për të

cilin kemi luftuar. Në disa raste rezultati nuk është ai që duam. Por, kjo varet nga ne, vetëm nga ne, sepse nuk ka asnjë tjetër për të fajësuar. Tifozët tanë edhe një herë tjetër kanë qenë fantastikë në

mbështetjen e vazhdueshme që na kanë dhënë. Ata meritojnë më të mirën, shumë më mirë, dhe jemi ne ata që duhet t'ua japim këto. Momenti është tani", ka thënë Ronaldo.



Shqipëria pritet me fishkëllima në garën e boksit në Beograd

Tiranë, 25 tetor - Kampionati Botëror i Boksit u hap zyrtarisht të dielën, më 24 tetor, në Beograd. Kosova përfundimisht nuk merr pjesë në këtë organizim për shkak të moslejimit të autoriteteve serbe që sportistët të hyjnë në territorin e Serbisë me simbole shtetërore. Megjithatë, edhe pse Federata e Boksit e Shqipërisë ka paralajmëruar se do të tërhiqet nga gara për shkak të Kosovës, kjo gjë nuk ka ndodhur si pasojë e presioneve që ka bërë Qeveria e Shqipërisë dhe Federata Ndërkombëtare e Boksit (AIBA). "Na është thënë se në rast të mospjesëmarrjes do të sanksionohemi me dhjetë vjet mospjesëmarrje në çdo aktivitet tjetër ndërkombëtar të AIBA-s", ka thënë për "Radion Evropa e Lirë", kapiteni i ekipit të Federatës së Boksit të Shqipërisë, Nelson Hysa. Ai shtoi se gjatë hapjes zyrtare të kampionatit momenti i parakalimit të sportistëve nga Shqipëria me flamurin shtetëror është përcjellë me fishkëllima dhe gjuajtje me gjësende të ndryshme.

"Normalisht, këtu (Beograd) jemi pa dëshirën tonë. Kemi presion të vazhdueshëm. Kur dola me flamur të Shqipërisë kishte brohoritje, fishkëllime, gjuajtje. Mbrëmë në hotel ka qëndruar Policia e Serbisë për shkak të sigurisë sonë", ka shtuar Hysa. Ndryshe, autoritetet kufitare serbe, gjatë fundjavës, për tri herë me radhë i kanë ndaluar hyrjen



në Serbi delegacionit të përfaqësueses së Kosovës në boks për shkak se Serbia nuk e njeh shtetin e Kosovës, respektivisht simbolet e saj. Besim Brahimi, selektor i Federatës së Boksit të Kosovës, tha për "Radion Evropa e Lirë" të hënën se më nuk do tentojnë të marrin pjesë në këtë kampionat. Sipas agjendës, boksierët e Kosovës të hënën, më 25 tetor, është dashur ta fillojnë garën. "Ka marrë fund gjithçka, më nuk tentojmë. Në pikën kufitare na është thënë se është urdhër i Qeverisë së Serbisë që nuk lejon të marrim pjesë me simbole shtetërore në fanella. Pa simbole nuk pranojmë", ka thënë Brahimi për "Radion Evropa e Lirë". Federata Ndërkombëtare e Boksit (AIBA), të shtunën, më 23 tetor, tha se Kosova nuk duhet të trajtohet ndryshe nga shtetet e tjera. Në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", AIBA ka

thënë se pret që delegacioni i Federatës së Boksit të Kosovës të trajtohej "jo ndryshe nga delegacionet e çdo anëtar tjetër të AIBA-s", dhe shtoi se pret që Kosova të marrë pjesë në këtë kampionat. Kosova është pjesë e AIBA-s që prej vitit 2014. "Ne besojmë që të gjithë atletët duhet të kenë shanse të njëjta për të garuar dhe për t'i treguar aftësitë e tyre më të mira në ring. Sporti ka për qëllim t'i bashkojë njerëzit dhe duhet të jetë i lirë nga politikat kombëtare", ka thënë AIBA.

Kampionati Botëror i Boksit zhvillohet në Beograd nga data 24 tetor deri më 6 nëntor 2021. Në këtë kampionat do të marrin pjesë më shumë se 500 atletë nga 88 shtete. Ata do të garojnë në 13 kategori të ndryshme. Kosovën në këtë kampionat ishte paraparë që ta përfaqësonin tre boksierë: Bashkim Bajoku, Shpëtim Bajoku dhe Patriot Behrami.

Hysenagolli, MVP i xhiros së parë

Prishtinë, 25 tetor - Në fundjavë u zhvillua java e parë e Ligës Unike, duke dhuruar ndeshje interesante. Basketbollisti me efekshmërinë më të lartë ishte Endrit Hysenagolli i Tirana Neptun, 38. Ai ndaj Rahovecit shënoi 24 pikë dhe kishte 18 kërcime, katër asistime dhe një top të vjedhur, duke qenë lojtari i ndeshjes, për ta ndihmuar skuadrën tiranase ta shënojë fitoren e parë në këtë edicion. Kampioni Golden Eagle Ylli mundi Vllazninë e Shkodrës 67-



79, ku te therandasit u dalluan Barret Benson me 14 pikë e 12 kërcime dhe Erjon Kastrati me 17 pikë e gjashtë kërcime. Kamza Basket regjistroi fitoren e parë, duke mundur Prizrenin 16 me

rezultat 91:96, ku më i dalluari ishte Matthew Eldridge me 23 pikë, 11 kërcime dhe tri asistime. Fitoren e parë e shënoi Peja, duke mundur Teutën në udhëtim 73:82, derisa në parket më i miri ishte kroati i Pejës, Henrik Sirko me 22 pikë, 11 kërcime dhe katër asistime.

Topesëshja: Endrit Hysenagolli i Tirana Neptun, Barret Benson dhe Erjon Kastrati të Golden Eagle Yllit, Matthew Eldridge i Kamza Basket dhe Henrik Sirko i Pejës.

SHKURT

Valentino Rossi: Gara më e bukur, do të doja që sezoni të mbaronte këtu

Valentino Rossi ka zhvilluar të dielën garën e tij të fundit para publikut të tij, në pistën italiane të Misano. Ai u klasifikua i 10-ti, rezultati i tij më i mirë sezonal me Yamaha Petronas por, mbi të gjitha, i gjithë publiku ishte veshur me të verdhë dhe mbante numrin 46 në duar. "Ishte gjithçka e jashtëzakonshme, mjaft e bukur. Kam menduar që të ruaj këtë kujtim në mendjen tim dhe të mos i zhvilloj dy garat e fundit. Atmosfera ishte fantastike dhe i falënderoj të gjithë për mbështetjen që më kanë dhënë në gjithë këto vite. Faleminderit!", ka thënë Rossi.

Kloppi: Ajo që bëme kundër Unitedit ishte e çmendur

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, e ka të vështirë t'i gjejë fjalët e duhura për të përshkruar fitoren 0-5 ndaj "Djajve të Kuq". "Çfarë mund të them? A e prisja këtë? Jo. Ajo që bëme ishte e çmendur. Presioni i lartë, fitimi i topave, shënuan gola të mrekullueshëm. U thashë futbollistëve në pjesën e parë të luanin më mirë. E kontrolluam lojën pas golit të pestë, nuk kishte të bënte me shënimin e më shumë golave, rëndësi kishte të mos kishim dëmtime", ka thënë Klopp. "Rezultati është i çmendur, pyeta nëse ka pasur një rezultat të tillë në histori. Lojtarët shkruan një pjesë të bukur të historisë. Është e veçantë, por ne nuk festojmë si të çmendur. Kemi respekt për kundërshtarët. Ishim me fat në disa momente. Unitedi nuk është në momentin më të mirë", ka shtuar Klopp.

Wolfsburgu shkarkon Van Bommel

Skuadra e Wolfsburgut ka shkarkuar trajnerin Mark van Bommel. Pas katër humbjeve radhazi në kampionat, holandezi nuk do të jetë më pjesë e "Ujqërve". Të shtunën skuadra e Wolfsburgut nuk arriti të fitonte në shtëpi ndaj Fraiburgut duke u mundur me rezultatin 2-0. Kjo solli një pakënaqësi të tifozët të cilët shpërthyen ndaj ish-lojtarit të Bayern Munchenit, Barcelonës dhe Milanit. Klubi mori dje vendimin për ta larguar pas nëntë javësh Van Bommel, teksa si pasues të tij Wolfsburgu emëroi në krye të bankinës asistentin e holandezit, 57-vjeçarin gjerman Majkell Frontcek.

Verstappen: Fitorja më e vështirë, Mick më ndihmoi dy herë në xhiron e fundit

Piloti holandez Max Verstappen shprehet se triumfi në pistën e Austinit ishte i vështirë për të, sidomos pas startit jo të mirë të garës, ku humbi kryesimin. "U detyruam të ndryshonim strategji, duke hyrë më shpejt për t'i ndërruar gomat. E dinim që kjo do të kishte pasoja në fund, por ia dolëm mbanë. Ishte suksesi më i vështirë i këtij sezoni", ka thënë Max Verstappen. "Edhe në ndalesën e dytë i ndërruam më herët gomat se Mercedesi, e dinim që do të vuanim, por ia dolëm mbanë. Lewisi u afrua shumë, por më duhet të falënderoj Mick Schumacherin. Më ndihmoi dy herë në xhiron e fundit. Fillimisht në vijën e drejtë, pasi përdora DRS-në për ta ruajtur distancën me Lewisin dhe më pas hapi krahun pa më krijuar probleme", ka shtuar Verstappen.

Inzaghi: Juve mund të na ndëshkonte vetëm nga penalltia

Kampioni në fuqi i Italisë, Interi, ka luajtur bars në derbin ndaj Juventusit (1-1). Trajneri Simone Inzaghi ka thënë se skuadra e tij dominoi në ndeshje dhe se vetëm nga

penalltia mund të pësonte gol nga "Zonja e Vjetër". "Penalltia ishte e vetmja mënyrë që mund të pësonim gol. Ne e drejtuam lojën nga fillimi deri në fund, nuk i lejuam asgjë

Juventusit. Janë dy pikë të hedhura dëm që nuk më pëlqejnë. Gjyqtari ishte dy metra larg, thotë se gjithçka është në rregull dhe më pas vendos të akordojë penallti",

ka thënë Inzaghi. "Në pjesën e parë në kontrolluam në çdo pjesë të fushës. Ne luftuam shumë, pastaj e dinim se Juventus kishte mundësinë të hidhte në fushë lojtarë

shumë të rrezikshëm. Ne u tërhoqëm disi, por gjithsesi mendoj se nuk bëme asnjë gabim me një ekip aq të fortë sa Juventus", ka shtuar Inzaghi.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Auto Leci" SH.P.K. me pronar Shpend Leci Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 811866956, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Auto Leci" D.O.O. Shpend Leci Fushë Kosovë, donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik Identifikues: 811866956, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Auto Leci" L.L.C. Shpend Leci Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: Unik Identifikues: 811866956 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Kompania për Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e Kopshteve te Luani" SH.P.K. me pronar Luan Sahiti, Adresa - Rruga Ismail Gubetini - Nedakoc në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811582388, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Kompania për Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e Kopshteve te Luani" D.O.O. Luan Sahiti, Adresa - Rruga Ismail Gubetini - Nedakoc në Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811582388, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Kompania për Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e Kopshteve te Luani" L.L.C. Luan Sahiti, Adresa - Rruga Ismail Gubetini - Nedakoc Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 811582388 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Fidaim Avdiushpall të pavlefshme dëftesat nga kl. 6 deri të 9, të shkollës Fillore "Naim Frashëri" Prishtinë.

► Besart Selmani shpall të pavlefshme Licencën e Punës të Fizioterapisë të lëshuar nga Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës.

► Bernardina Alijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III, IV dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" drejtimi Farmaci Gjakovë.

► Ema Duraj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VI shfmu " Bajram Curi " Romaje.

► Fiorda Hoti shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Nasar Imeri shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Perparim Rizanaj shpall të pavlefshme dëftesat kl. I- VIII shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.

► Xhevdet Dervishaj nga Nasheci i Prizrenit, shpall të pavlefshme Diplomën e studimeve themelore universitare të lëshuar nga Kolegji "Dardania", drejtimi: Banka, Financa dhe Kontabilitet.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjë dhe dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

